

2025
B U X H E T I



1.9+

miliardë lekë

INDUSTRIA E MBROJTJES



3-9 NËNTOR

JAVA E MBROJTJES



619+

milionë lekë

AKTI NORMATIV RRIT BUXHETIN E MBROJTJES

Akti Normativ i miratuar për buxhetin e vitit 2025 parashikon rritje të fondeve për mbrojtjen, forcimin e kapitalit njerëzor dhe kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura. Një pjesë e investimeve do të shkojë për nisjen e prodhimit të armatimit, mjeteve dhe pajisjeve ushtarake “Made in Albania”, si dhe për financimin e projekteve në infrastrukturën kritike.

★★★★★

mod.gov.al

JM

MBROJTJA E JETËS, MISSION I PËRBASHKËT

Në përmbyllje të muajit të ndërgjegjësimit në luftën kundër kancerit të gjirit, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, dhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala morën pjesë në një aktivitet sensibilizues në Regjimentin e Këmbësorisë së Veriut, Vau i Dejës, në kuadër të fushatës për ndërgjegjësimin e depistimit të hershëm të kancerit të gjirit. Dy ministrat përcollën mesazhin e përbashkët të bashkëpunimit ndër-institucional në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të qytetarëve.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

GT_BB_MOCNOC

UNKNOWN HOST

10.107.11.10

2a07:1181:100:ff02::2

EKSPERTËT E KOMANDËS KIBERNETIKE NË STËRVITJEN NDËRKOMBËTARE

Ekspertët e Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes morën pjesë këtë javë në stërvitjen ndërkombëtare “Crossed Swords 2025”, të organizuar nga NATO CCDCOE me mbi 40 vende pjesëmarrëse. Aktiviteti përfshiu simulime të sulmeve kibernetike, kundërmasa dhe analiza duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar.





SHQIPËRIA, E PARA NË STËRVITJEN “GUARDIAN PURPLE 2025”

Ekipi i Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes të Forcave të Armatosura u rendit i pari në stërvitjen ndërkombëtare “Guardian Purple 2025”, të organizuar nga NATO Maritime Interdiction Operational Training Centre (NMIOTC). Përmes simulimeve të sulmeve dhe kundërsulmeve virtuale, pjesëmarrësit testuan aftësitë për zbulimin dhe reagimin ndaj incidenteve kibernetike.

★★★★★

mod.gov.al

JM



PËRFUNDON KURSI BAZË I NËNOFICERIT

11 efektivë të Komandës Mbështetëse dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura, përmbyllën me sukses dhe rezultate të larta “Kursin Bazë të Nënoficerit”. Për një periudhë 8 javore, përmes programeve teorike bashkëkohore dhe veprimeve praktike, kursantët zhvilluan aftësi teknike, menaxhuese në specialitetin logjistikë.



RRISIM GATISHMËRINË PËR EMERGJENCAT CIVILE

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Reparti Ushtarak nr.1033 zhvilluan një stërvitje në Korçë për të rritur gatishmërinë dhe bashkëpunimin në emergjenca civile, duke demonstruar procedura reagimi dhe menaxhimin e situatave të fatkeqësive natyrore. Aktiviteti theksoi profesionalizmin e efektivëve dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet forcave ushtarake dhe institucioneve civile.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

BATALIONI I XHENIOS AKSION NË DURRËS E HIMARË

Ekspertët EOD i janë përgjigjur thirrjes së autoriteteve civile në Durrës dhe Himarë, duke identifikuar dhe asgjësuar municionet luftarake të paplasura. Aktiviteti garanton sigurinë publike dhe parandalon rreziqet nga municionet e mbetura në territor.

JM



ANIJA “LISSUS” SHPËTON 18 EMIGRANTË NË EGJE

Anija “Lissus” (P-133) ndërhyri në një operacion kërkim–shpëtimi, duke ndihmuar një gomone me 18 emigrantë. Falë ndërhyrjes së shpejtë dhe profesionalizmit të ekuipazhit, operacioni u përfundua me sukses.

JM





SUKSES I AFA NË MARATONËN NDËRKOMBËTARE

Maratona Ndërkombëtare e Durrësit mbledhi mbi 1000 garues nga 18 shtete në garat 5 km dhe 10 km. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe ekipi i Akademisë së Forcave të Armatosura, i përfaqësuar nga studentë dhe oficerë. Nënkolonel Bledar Mesi u rendit në vendin e dytë në garën 10 km, ndërsa studentët e AFA-së shfaqën performancë të shkëlqyer dhe shpirt të lartë garues.

★★★★★



“MBROJTJA CIVILE NË TURNE 2025”

Në qarkun e Korçës po zhvillohen në mënyrë të integruar stërvitja funksionale “Reagimi ndaj tërmeteve (Sizmika) 2025” si dhe fushata kombëtare e ndërgjegjësimit “Mbrojtja Civile në Turne 2025”. Aktivitetet organizohen nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), në bashkëpunim me institucionet qendrore e vendore, në kuadër të projektit RESEAL.

